



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MAT
KRYETARI

Nr. _____ Prot.

Burrel, më _____.____.2024

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

Drejtuar: Operatorit Ekonomik: “ULZA” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **J679029280**, me seli:
*Tiranë, Tiranë, TIRANË, Njësia bashkiake nr. 5, rruga “Zef Jubani”, ndërtesa 15,
hyrja 19, ap 1, kodi postar 1019.*

Procedura e prokurimit: “E Hapur - Punë”, prokurim elektronik.

Numri i referencës së procedurës: **REF-03594-05-02-2024.**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “*Rikonstruksion shkolla 9- vjeçare “Ali Metra”, Komsi dhe sistemi i ngrohjes + ndërtim palestre*”, me fond limit në vlerën: **97 321 817.23** (nëntëdhjetë e shtatë milion e treqind e njëzet e një mijë e tetëqind e shtatëmbëdhjetë pikë njëzet e tre) **lekë pa TVSH**, ndarë për vitin **2024** në vlerën: **25 000 000** (njëzet e pesë milion) **lekë pa TVSH**, nga buxheti i shtetit, për vitin **2025** në vlerën: **58 041 420.6** (pesëdhjetë e tetë milion e dyzet e një mijë e katërqind e njëzet pikë gjashtë) **lekë pa TVSH**, nga buxheti i shtetit, ndërsa për vitin **2026** në vlerën: **14 280 396.63** (katërmëdhjetë milion e dyqind e tetëdhjetë mijë e treqind e nëntëdhjetë e gjashtë pikë gjashtëdhjetë e tre) **lekë pa TVSH**, nga grandit i bashkisë: 8 333 333.33 (tetë milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre pikë tridhjetë e tre) **lekë pa TVSH** dhe nga të ardhurat: 5 947 063.30 (pesë milion e nëntëqind e dyzet e shtatë mijë e gjashtëdhjetë e tre pikë tridhjetë) **lekë pa TVSH**, me afat zbatimi: **6** (gjashtë) **muaj** nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit.

Publikime të mëparshme: *nuk ka patur*

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 23, datë 07 Maj 2024

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik: “**ULZA**” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **J679029280**
Vlera: **89 795 759.46** (tetëdhjetë e nëntë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e nëntë pikë dyzet e gjashtë) **lekë pa TVSH.**
2. Operatori Ekonomik: “**RAFIN COMPANY**” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **L52125110A**
Vlera: **93 805 364.99** (nëntëdhjetë e tre milion e tetëqind e pesë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e katër pikë nëntëdhjetë e nëntë) **lekë pa TVSH.**
3. Operatori Ekonomik: “**SENKA**” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **J94808405Q**
Vlera: **Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.**

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. **Operatori Ekonomik: “RAFIN COMPANY” Sh.p.k.,** me numër Nipt-i: **L52125110A**
2. **Operatori Ekonomik: “SENKA” Sh.p.k.,** me numër Nipt-i: **J94808405Q**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtëm:

I. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik, shoqëria “RAFIN COMPANY” Sh.p.k., për pjesëmarrje në tender, rezulton se nuk përmbush të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Kriteret e Veçanta të Përzgjedhjes/Kualifikimit, si më poshtë:

1. Nuk është përmbushur kriteri i **pikës 1 gërma “b”/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit**, pasi konstatohet se, nuk është paraqitur *Sigurimi i Ofertës, sipas Shtojcës 3.*
2. Nuk është përmbushur kriteri i **pikës 2.3.5/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit**, pasi konstatohet se, nuk është paraqitur dokumentacioni i kërkuar, si: *Autorizimet e prodhuesit/ distributorit, Katalogjet dhe Çertifikatat ISO 9001 të prodhuesit, për listën e mallrave/ materialeve të kërkuar.*
3. Nuk është përmbushur kriteri i **pikës 2.3.7 gërma “a, b, c, d, e, g”/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit**, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur konstatohet se, në seksionin B: **DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”/ Pjesa III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8, nuk ka deklaruar se disponon:**
 - **Stafit të drejtuesve teknik: minimumi 1 (një) Inxhinier Ndërtimi (Profili strukturist), 1 (një) Inxhinier Elektronik, 1 (një) Inxhinier Hidroteknik, 1 (një) Inxhinier Gjeodet/ Topograf/ Markshajder;**

- Stafit ndihmës për kryerjen e punimeve: minimumit 1 (një) Arkitekt, dhe 1 (një) Inxhinier Gjeofizike/ Sizmiologji;
 - Punonjësit e specializuar/ kualifikuar: 3 (tre) punonjës Teknik ndërtimi, por vetëm 1 (një) të tillë, 1 (një) punonjës Teknik hidraulik, 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës Murator/ Suvatues, 12 (dymbëdhjetë) punonjës Termoizolues por vetëm 2 (dy) të tillë, 6 (gjashtë) punonjës Hidraulik, por vetëm 1 (një) të tillë, 6 (gjashtë) punonjës Specialist elektrik, por vetëm 1 (një) të tillë, 3 (tre) punonjës Specialist elektronik, 3 (tre) punonjës Instalues sisteme ngrohëse, 6 (gjashtë) punonjës Konstruktore të strukturave metalike, 6 (gjashtë) punonjës Specialist parketi, 6 (gjashtë) punonjës Bojaxhi por vetëm 2 (dy) të tillë, si dhe nuk ka paraqitur Tabelën e plotësuar me të dhënat e kërkuara për punonjësit e specializuar/ kualifikuar.
 - Të paktën 20 (njëzet) punonjës të specializuar dhe çertifikuar për përdorim dhe punime në skela, por vetëm 1 (një) të tillë;
 - 1 (një) mjek të përgjithshëm;
 - 1 (një) specialist ekspert zjarrefikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin
4. Nuk është përmbushur kriteri i **pikës 2.3.8/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit**, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur konstatohet se, në seksionin B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”/ Pjesa III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8, nuk ka deklaruar se disponon: minimumi **5 (pesë)** shoferë të mjeteve të rënda, dhe **3 (tre)** manovratorë/automakinist, por vetëm **2 (dy)** nga këto të fundit.
5. Nuk është përmbushur kriteri i **pikës 2.3.9 gërma “a dhe b”/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit**, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur konstatohet se, në seksionin C: DEKLARATË “Për disponimin e mjeteve/pajisje/makinerve të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate”/ Pjesa III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit, të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8, nuk ka deklaruar se disponon: 2 (dy) Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës min. 15 ton, 2 (dy) Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10 - 15 ton, 2 (dy) Kamion/ Kamionçinë me kapacitet mbajtës 3.5 - 10 ton, por vetëm 1 (një) të tillë, 2 (dy) Kamion me Vinç, por vetëm 1 (një) të tillë, 3 (tre) Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri në 3 ton, por vetëm 1 (një) të tillë, 1 (një) Rimorkiator për lëvizjen e mjeteve, 1 (një) Fadromë me goma, 1 (një) Autobetoniere, 1 (një) Presë betoni, 1 (një) Autobot uji, 2 (dy) Pompë suvatimi, 1 (një) Gazogjen, 1000 m² Skeleri, 3 (tre) Vibrator thellësie, si dhe mjetet dhe pajisjet e mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit (Kokore, Komplet i ndihmës së shpejtë, Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra, Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt).
6. Nuk është përmbushur kriteri i **pikës 2.3.10/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit**, pasi konstatohet se, nuk është paraqitur dokumentacioni i kërkuar për disponimin/ kontraktimin e 1 (një) kantier për prodhimin e betonit në pronësi ose me qera ose me kontratë furnizimi.

7. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.11/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur mostrat për pajisjet/materialet e kërkuar ditën e hapjes së ofertave pranë autoritetit kontraktor.

II. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vërejt se Operatori Ekonomik Pjesëmarrës: “SENKA” Sh.p.k., nuk ka paraqitur Ofertë Ekonomike (*sipas Shtojcës 1 të DST-së*) në zbatim të nenit 29 të Vendimit Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 e dokumentat për përmbushjen e kriterëve të përzgjedhjes/ kualifikimit e kërkuar në DST,

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik: “ULZA” Sh.p.k., me seli: Tiranë, Tiranë, TIRANË, Njësia bashkiake nr. 5, rruga “Zef Jubani”, ndërtesa 15, hyrja 19, ap 1, kodi postar 1019, me numër Nipt-i: J679029280, se oferta e paraqitur një vlerë të përgjithshme prej: **89 795 759.46** (tetëdhjetë e nëntë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e nëntë pikë dyzet e gjashtë) **lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [Bashkisë Mat/ Sektorit Juridik dhe Prokurimeve Publike, me adresë: Sheshi “Kastriotët”, Nr.1, KP 8001, Burrel] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda **10 (dhjetë) ditëve** nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet siguri i ofertës suaj dhe do të procedohet konform dispozitave ligjore në fuqi të parashikuara nga Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar).

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraparak)

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) _____

Titullari i Autoritetit Kontraktor